

University of Business and Technology in Kosovo

**UBT Knowledge Center**

---

Theses and Dissertations

Student Work

---

Summer 8-2013

## **QEVERISJA E KORPORATAVE SI MEKANIZËM PËR NXITJEN E ZHVILLIMIT EKONOMIK**

Shkumbin Shllaku

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the **Business Commons**

---



Departamenti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

**QEVERISJA E KORPORATAVE SI MEKANIZËM PËR NXITJEN E  
ZHVILLIMIT EKONOMIK**

**Temë diplome**

**Shkumbin Shllaku**

**Shtator, 2013**

**Prishtinë**



Departamenti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Temë Diplome

Viti akademik 2009 – 2012

Shkumbin Shllaku

**QEVERISJA E KORPORATAVE SI MEKANIZËM PËR NXITJEN E  
ZHVILLIMIT EKONOMIK**

Mentori: Emrush Ujkani, PhD kandidat

Gusht, 2013

## **ABSTRAKTI**

Ky punim na tregon se si një qeverisje e mirë e korporatave ndikon në zhvillim ekonomik dhe shoqëror. Qeverisja e mirë e korporatave jo vetëm që e forcon kapitalin e tregut, por i tërheqë investitorët e huaj dhe e zvogëlon paqëndrueshmërinë ekonomike ndërsa një qeverisje jo e mirë e korporatave mund të na qoj në kolaps ekonomik.

Kriza e fundit financiare është shkaktuar si rezultat i dështimit në qeverisjen e korporatave dhe institucioneve financiare, gjë që ka shpie në dëmtimin serioz të ekonomisë botërore. Këto ngjarje kane bërë që ekonomistët, sektorët e korporatave dhe politike bërësitë tërë botën t'i kuptojnë pasojat afatgjatë të sistemit të dobët të qeverisjes së korporatave. Krizat shkaktohen si rezultat i disa faktorëve strukturorë dhe kjo na bën të kuptojmë se pse qeverisja e korporatave është një faktor kyç për zhvillimin ekonomik dhe mirë qenien e shoqërisë.

Sot investimi në tregje private është shumë i rëndësishëm për shumë ekonomi dhe një gjë e tillë mund të arrihet vetëm me një qeverisje me të mirë të korporatave. Alokimi i kapitalit është bërë shumë kompleks sepse zgjedhjet për të investuar janë shumëfishuar si rezultat i hapjes dhe liberalizimit të tregjeve financiare. Reformat strukturorë dhe konkurrenca kane bërë që monitorimi i përdorimit të kapitalit të jetë shumë kompleks prandaj është paraqitur nevoja e një qeverisje të mirë të korporatave.

## **Përmbajtja**

<b>ABSTRAKTI.....</b>	<b>3</b>
<b>1. HYRJA .....</b>	<b>5</b>
<b>2. HISTORIKU I QEVERISJES SË KORPORATAVE .....</b>	<b>6</b>
<b>3. QEVERISJA E KORPORATAVE SI NXITËS I ZHVILLIMIT EKONOMIK NE BOTË .....</b>	<b>9</b>
<b>3.1. KORNIZA ANALITIKE: MODELET E QEVERISJES SE KORPORATAVE DHE AKSIONAREVE .....</b>	<b>10</b>
3.1.1. MODELI I AKSIONAREVE "SHAREHOLDER" .....	10
3.1.2 MODELI "STAKEHOLDER" .....	12
<b>4. EFEKTET E QEVERISJES SË KORPORATAVE NË PERFORMANCËN E FIRMËS .....</b>	<b>14</b>
<b>4.1. QEVERISJA E KORPORATAVE DHE MBROJTJA E INVESTITORËVE .....</b>	<b>15</b>
<b>5. QEVERISJA E NDËRMARRJEVE PUBLIKE NË KOSOVË .....</b>	<b>17</b>
<b>6. KONKLUDIMI.....</b>	<b>20</b>
<b>7. METODOLOGJIA .....</b>	<b>21</b>
<b>8. LITERATURA .....</b>	<b>22</b>

# 1. HYRJA

Qeverisja e korporatave<sup>1</sup> është sistem i cili shërben për menaxhimin dhe kontrollin e kompanive. Ky sistem përfshinë rregullat dhe marrëdhëniet në mes të menaxhmentit të kompanisë dhe bordit të saj si dhe synimet për të cilat qeverisen ato korporata.

Qeverisja e korporatave me se shumti ka të beje me parandalimin e konflikteve në mes të palëve të interesit brenda kompanisë siç janë : kreditorët, punëtorët, klientët, menaxhmenti, komuniteti dhe qeveria. Mënyra më e mirë për parandalimin e konflikteve të lartë-përmendura përfshinë proceset, ligjet dhe institucionet të cilat kane ndikim në mënyrën se si kontrollohet kompania. Njëra prej elementeve më të rëndësishme në qeverisjen e korporatave është niveli i përgjegjësisë se njerëzve të cilët janë të përfshirë në biznes.

Në kompanitë e mëdha tek të cilat pronësia dhe menaxhmenti janë të ndara dhe aty ku nuk ka kontrollë të pronësisë, mund të paraqiten disa mosmarrëveshje në mes të pronarëve dhe menaxhmentit të lartë sepse këta të fundit kanë më shumë informacione dhe interesa të ndryshëm.

Transparenca dhe llogari-dhënia janë elementet më të rëndësishme për parandalimin e konflikteve të lartë përmendura dhe për një qeverisje të mirë të korporatave. Kjo përfshinë :

- Posedimi i informacioneve kualitative nga kompanitë
- Proces të qartë dhe kredibil të vendim-marrjes nga ana e kompanisë
- Pronaret duhet marre në konsideratë informatat të cilat i pranojnë dhe të marrin vendime të duhura në baze të këtyre informatave.

Gjatë viteve 2001 – 2002 shume kompani moderne janë shkatërruar si rezultat i mashtrimeve financiare dhe llogari-dhënies.

---

<sup>1</sup> Wikipedia;  
[http://en.wikipedia.org/wiki/Corporate\\_governance](http://en.wikipedia.org/wiki/Corporate_governance)

## 2. HISTORIKU I QEVERISJES SË KORPORATAVE

### 2.1 Çka është qeverisja e korporatave?

Qeverisja e korporatave<sup>2</sup> është një koncept relativisht i ri i cili është zhvilluar mjaft gjatë dekadës së fundit. Ky koncept është zhvilluar për t'ju adresuar rritjes së përgjegjësisë sociale të korporatave dhe për një pjese marrje me të madhe të aksionareve dhe korporatave në vendim marrje. Termi qeverisje e korporatave mund të shpjegohet me anë të dy definicioneve si ne vijim:

- Sjellja reale e korporatave e cila matet me anë të performancës, eficiencës, zhvillimit, strukturës dhe trajtimit të aksionareve dhe korporatave.
- Korniza normative e punës, rregullat me të cilat operon një kompani, tregjet financiare dhe tregjet e punës.

Për studimin e vendeve të caktuara ose firmave në ato vende, definicioni i parë është më i përshtatshëm sepse përfshinë shumë çështje siç janë: mënyra e veprimit të bordit të drejtorëve, roli i kompensimit ekzekutiv që përcakton performancën e firmës, marrëdhëniet në mes të politikave të punëtorëve dhe performancës së firmës dhe rolet e shumta të aksionareve dhe korporatave.

Për studime krahasimi, definicioni i dytë është më i përshtatshëm sepse tregon dallimet në mes të kornizave normative të punës të cilat ndikojnë në strukturën e sjelljes së firmave, investitorëve dhe të tjerëve.

Ekonomistët Shleifer dhe Vishny (1997) e kanë dhënë këtë definicion për qeverisje të korporatave: “Qeverisja e korporatave merret me mënyrat në të cilat furnizuesit e financimit të korporatave e sigurojnë vetën që do t’ju kthehen investimet e tyre”. Ky definicion shpjegon që qeverisja e korporatave merret me zgjidhjen e problemeve të mbledhura të veprimit në mes të investitorëve të shpërndarë dhe eliminimit të konflikteve të interesit në mes garantuesve të ndryshëm të korporatës.

Një definicion më i gjerë do ta karakterizonte qeverisjen e korporatave si disa mekanizma me anë të cilëve veprojnë firmat kur pronësia është e ndarë nga menaxhmenti.

---

<sup>2</sup> Stijn Claessens and Burcin Yurtoglu, 2012.  
*10 FOCUS, Corporatë Governance and Development*

Ky definicion në një mënyrë i afrohet definicionit të cilin e ka përdorur Sir Adrian Cadbury (udhëheqës i Komitetit për Aspektë Financiare të Qeverisjes së Korporatave në Mbretërinë e Bashkuar) që thotë: “Qeverisja e korporatave është sistem me ane të të cilit udhëhiqen dhe kontrollohen kompanitë”<sup>3</sup>. (Cadbury Committee 1992, parathënie).

Zingales 1998<sup>4</sup> e definon qeverisjen e korporatave si një “grup të përbërë të detyrimeve të cilat e përcaktojnë fitimin e krijuar nga firma si rezultat i marrëdhënieve në mes të aksionareve”. Duke u bazuar në këtë definicion vijmë në përfundim që qeverisja e korporatave mund të përfshinte marrëdhëniet në mes të aksionarëve, kreditorëve, korporatave, tregjeve financiare, institucioneve dhe korporatave si dhe marrëdhëniet në mes të punëtorëve dhe korporatave.

## 2.2 Pse i kushtohet më shumë vëmendje qeverisjes së korporatave?

Krizat financiare që kanë ndodhur kohëve të fundit i kanë dëmtuar punëtorët, shpenzimet e konsumatorëve, pensionet, financat e qeverive lokale dhe kombëtare si dhe ekonominë në tërësi. Dobësitë në qeverisjen e korporatave janë parë si arsye kryesore për nxitjen asimetrike të kompensimit për menaxherët e moshuar dhe epërsinë e bordit që i vlerësojnë përfitimet afat shkurtër në krahasim me ato afat gjatë.

Këto kriza janë shkaktuar si rezultat i disa faktorëve strukturor dhe për këtë arsye qeverisja e korporatave është bërë faktor kyç për zhvillim ekonomik në shume vende.

Qeverisja e mirë e korporatave i ka përforcuar investimet në tregjet private dhe për këtë arsye është bërë mjet i rëndësishëm për shumë ekonomi të vendeve të botës. Kompanitë e ndryshme kanë investuar në tregje publike në tërë botën për ta rritur kapitalin e tyre, kështu që shoqëritë e përbashkëta dhe ortakëritë janë shndërruar në korporata.

Progresi teknologjik, hapja e tregjeve financiare, liberalizimi i tregjeve, alokimi i kapitaleve nëpër vende të ndryshme kanë ndikuar në një qeverisje të mirë dhe transparencë dhe në këtë mënyrë investitorët kanë marrë pasqyra të qarta financiare.

Rritja e rolit të investitorëve institucional në shume vende ka bërë që shumë ekonomi të kalojnë nga sistemi i përcaktuar i përfitimit pensional në plane të përcaktuara kontribuuese. Programet financiare për reduktimin e rregullave shtetërore dhe reformat e ndryshme e kanë

---

<sup>3</sup> Corporate Governance; Kesho Prasad, 2009

<sup>4</sup> Corporate Governance and the Theory of the Firm; Luigi Zingales



ndryshuar sistemin financiar botëror. Integrimi ndërkombëtar financiar është rritur mjaft gjatë dy dekadave të fundit dhe ka ndikuar në rritjen e tregtisë dhe investimeve. Në fund mbetet të shihet se si ekonomitë e vendeve të ndryshme të botës do të veprojnë për ta zvogëluar rrezikun nga ndonjë krize tjetër financiare e cila mund të ndikon në zhvillim ekonomik.

### **3. QEVERISJA E KORPORATAVE SI NXITËS I ZHVILLIMIT EKONOMIK NE BOTË**

Qëllimi i qeverisjes se korporatave përfshinë disa pika:

- I ofron tregut shërbime dhe të mira materiale
- Mbrojtja e ambientit
- Korporatat krijojnë mundësi për stafin e talentuar që të krijojnë pasuri për ta dhe për brezat e ardhshëm.
- Korporatat ndikojnë në rritjen e standardit të jetesës duke e rritur edhe fuqinë blerëse të shoqërisë. Ne këtë mënyrë ato ndikojnë edhe në rritjen e GDP-se së ekonomisë së një vendi.
- Korporatat ndikojnë në krijimin e qëndrueshëm të strukturave sociale dhe në këtë mënyrë edhe njerëzit bëhen me të devotshëm për përmbushjen e objektivave dhe qëllimeve të organizatës.
- Korporatat lejojnë rritjen e profesionalizmit, kompensojnë stafin, përforcojnë konsumin dhe të gjitha këto se bashku ndikojnë në zhvillim të përgjithshëm ekonomik.
- Zhvillimi i biznesit në mënyrë efikase kontribuon në suksesin e korporatave.

Korporatat janë të fuqishme dhe marrin pjesë edhe në formimin e ligjit. Ato krijojnë punë të reja për njerëzit të cilët njëkohësisht varen prej këtyre të fundit sepse në një mënyrë ato u sigurojnë mbijetesën. Korporatat e ruajnë identitetin e tyre jo vetëm duke prodhuar të mira material dhe duke ofruar shërbime, por ato shfaqen edhe si persona qeverisës. Avokatët mendojnë që firmat kanë të drejta identike politike, përveç të drejtës për të votuar e cila është e garantuar me kushtetutën e një shteti. Edhe korporatat duhet t'i kenë procedurat e tyre për marrjen e vendimeve të bazuara në parime morale. Këto korporata kanë përgjegjësi për të dhënë llogari lidhur me sjelljen e saj gjatë ushtrimit të veprimtarisë biznesore nëse një gjë e tillë vihet në pyetje. Në anën tjetër firmat kanë përgjegjësi që t'i ofrojnë konsumatorëve shërbime dhe të mira materiale kualitative. Kompanitë ekzistojnë për arsye ekonomike dhe qëllimi i tyre është maksimizimi i fitimeve. Për këtë shkak këto kompani duhet të jenë konkurruese për të mbijetuar në tregje. Fitimi siguron jetë gjatësinë e një kompanie. Tregjet përcaktojnë çmimet dhe konsumatorët paguajnë për atë që blejnë që do të thotë se kompania

nuk do të mbijetojë nëse nuk do t' i ofroje konsumatorëve shërbime dhe të mira materiale të cilat ata do të dëshironin t' i paguanin.

Korporatat janë të një natyre fleksibile sepse mund të jetë e vendosur në një vend të caktuar dhe të veprojë në një vend tjetër të botës.

### **3.1. KORNIZA ANALITIKE: MODELET E QEVERISJES SE KORPORATAVE DHE AKSIONAREVE**

Qeverisja e korporatave më së shumti ballafaqohet me problemin “principali-agjenti” ose me problemin “agjencia”. Marrëdhënia “principali-agjenti” shfaqet në rastet kur pronari i firmës nuk është i njëjtë me personin që e menaxhon atë. Investitorët që në rastin tonë paraqesin principalin i angazhojnë menaxheret “agjentët” që ta menaxhojnë kompaninë në mënyrë që të gjenerojnë të ardhura për investimet e tyre, ndërsa menaxhereve iu nevojiten këta investitorë sepse nuk kanë kapital të mjaftueshëm për investim vetanak. Sipas teorisë (Berle and Means, 1932)<sup>5</sup> ekziston një ndarje në mes të pronësisë dhe kontrollit në një ndërmarrje.

Korniza analitike na ndihmon që të kuptojmë se si qeverisja e korporatave mund të ndikoj në performancën e një ndërmarrje dhe zhvillimin ekonomik. Ekzistojnë dy modele të ndryshme të korporatës siç janë:

1. Modeli i aksionareve “shareholder” në baze të të cilit qeverisja e korporatave përshkruan një sistem formal të përgjegjësisë se menaxhmentit tek aksionaret në qeverisjen e korporatës;
2. Modeli stakeholder në bazë të të cilit qeverisja e korporatave përshkruan lidhjen në mes të marrëdhënieve formale dhe joformale duke përfshirë edhe korporatën.

#### **3.1.1. Modeli i aksionareve ”shareholder”**

Sipas modelit të aksionarëve “shareholder” objektivat e një ndërmarrje janë që t' i rrisin aksionet dhe të maksimizojnë profitin. Për të siguruar një gjë të tillë, menaxherët dhe drejtorët duhet të sigurohen që ndërmarrja vepron në interes të aksionareve. Në të shumtën e

---

<sup>5</sup> Berle and Means, 1932

rasteve ndarja ne mes të pronarit qe pranon profitin dhe vendim-marrjes ekzekutive ndikon qe sjellja e kompanisë të devijojë nga maksimizimi ideal i profitit. Një situatë e tillë mund të shfaqet si rezultat i problemit të lartë përmendur “principal - agjent” sepse interesat dhe objektivat e investitorëve dhe menaxhereve ndryshojnë kur ka ndarje të pronësisë dhe kontrollit. Menaxheret ne këtë rast nuk janë pronare të ndërmarrjes, prandaj ata nuk i bartin të gjitha shpenzimet dhe nuk i marrin benefitet e plota. Edhe pse objektivi i investitorëve është maksimizimi i vlerës së aksioneve të ndërmarrjes, menaxheret mund të kenë objektiva të tjera siç janë rritja e rrogave të tyre dhe rritja e aksioneve të tregut.

Ekzistojnë tri metoda kryesore qe përdoren për bashkërenditjen e interesave dhe objektivave ndërmjet aksionareve dhe menaxhereve dhe minimizimi i shpenzimeve të ndërmarrjes të cilat paraqitën si rezultat i ndarjes ndërmjet kontrollit dhe pronësisë. Këta metoda ndahen si ne vijim:

1. *Metoda e pare:* kjo metode ka për qëllim qe t’i shtyjë menaxheret qe të bëjnë një menaxhim efikas duke i bere interesat e menaxhereve dhe aksionareve të njëjta, për shembull planet ekzekutive të kompensimit, mundësitë e stoqeve, monitorimi direkt nga bordi etj.
2. *Metoda e dytë:* kjo metode përfshinë forcimin e të drejtave të aksionareve për një monitorim sa me të mirë të menaxhmentit. Kjo nënkupton mbrojtjen e pronësisë së investitorëve nga menaxheret përmes ligjit për shembull mbrojtja dhe zbatimi i të drejtave të aksionareve, ndalesat ndaj marrëveshjeve të brendshme etj.
3. *Metoda e tretë:* përfshinë masa indirektë të kontrollit të korporatës siç janë tregu menaxherial i punës dhe tregjet për kontroll të korporatave.

Modeli “shareholder” shpesh here has edhe ne kritika si rezultat i parashikimeve për ekzistimin e konflikteve ne mes të menaxhereve të fortë dhe aksionareve të dobët e të shpërndare. Teoria Berle dhe Means<sup>6</sup> (1932) thotë se njëra nga arsyet qe të unifikohet pronësia është si rezultat i mungesës së mbrojtjes së investitorëve. Përkundër korporatave ku menaxherët kane kontroll me të madh ndërsa aksionaret kane fuqi me të vogël, duhet të

---

<sup>6</sup> Berle and Means, 1932

krijohen korporata ne të cilat aksionaret kane pjesën me të madhe të kontrollit ne krahasim me menaxheret. Kjo mund të jetë një familje, individ apo thjeshtë një institut financiar.

### 3.1.2 Modeli “stakeholder”

Modeli “stakeholder” përfshinë një këndvështrim me të gjerë të kompanisë. Ne baze të modelit tradicional “stakeholder”, korporata është përgjegjëse për një numër me të madh të partnereve të “stakeholder” se sa aksionareve. Ky model thotë se korporatat duhet të jene institucione qe menaxhohen ne interes publik dhe performanca e korporatës varet nga një numër me i madh i partnereve të interesuar ne ndarjen e tregut dhe rritjen e marrëdhënieve tregtare me furnitorët dhe blerësit; si dhe performacën financiare.<sup>7</sup>

Modeli tradicional “stakeholder” shpesh here mund të jetë problematik për korporatat sepse është shume e vështirë për këto të fundit qe t’i përmbushin të gjitha objektivat e lartë përmendura. Blair (1995) ka paraqitur argumentet kundër këtij këndvështrimi: “ideja [...] për t’i dhënë menaxhereve dhe drejtoreve udhëzime të qarta ka dështuar dhe nuk ka siguruar mekanizma të zbatueshëm për t’u siguruar qe korporatat veprojnë ne baze të obligimeve të tyre sociale. Si rezultat i këtyre deficiteve, disa akademike dhe krijues të politike-bërjes ose persona të tjerë të cilët japin propozime për reforma ne qeverisjen e korporatave ende e përkrahin këtë model”<sup>8</sup>. Ne baze të modelit të ri “stakeholder”, firmat me të “mira” janë ato të cilët kane furnitorë, klientë dhe punëtorë të devotshëm. Ky model i ri “stakeholder” mund të jetë një lloj vazhdimësie e modelit “shareholder” dhe këtë mund ta shpjegojmë me ane të një shembulli si ne vijim: çdo here kur një kompani dëshiron të beje investime të caktuara performanca e kësaj të fundit varet nga kontributet prej burimeve të ndryshme të kapitalit njerëzor dhe fizik. Suksesi i kompanisë gjithashtu varet edhe nga rezultati i punës ekipore qe përfshin kontributet nga burimet e ndryshme siç janë investitorët, punëtorët, kreditorët dhe furnitorët prandaj është e rëndësishme qe aksionaret duhet t’i marrin parasysh edhe “stakeholder” të tjerë dhe të zhvillojnë marrëdhënie afatgjatë, besim dhe përkushtim ne mes të “stakeholder”-ve të ndryshëm. Edhe ky model ka problemet e saj të cilat paraqiten ne rastet kur kontratat janë të pa kompletuara dhe kompania dëshiron të beje investime të caktuara. Shpesh here punëtorët

---

<sup>7</sup> Mayer (1996), fq. 11

<sup>8</sup> Blair (1995), fq. 203

nuk investojnë ne kapitalin njerëzor brenda kompanisë sepse nuk janë ne gjendje që të përfitojnë nga investimi i tyre dhe i bëjnë shpenzimet që krijohen gjatë investimeve të tilla. Edhe kompanitë shpesh herë nuk i trajnojnë punëtorët sepse duhet t'i bëjnë shpenzimet të cilat shfaqen gjatë këtyre trajnimeve, dhe nuk mund të përfitojnë nga trajnimi i këtyre punëtorëve .

Ky model ka hasur në kritikë sepse menaxheret ose drejtoret shpesh herë mund të përdorin arsyet “stakeholder” për ta arsyetuar performancën e dobët të kompanisë. Përparësitë e modelit të “aksionareve” janë se ato sigurojnë udhëzime të qarta menaxhereve për t'i caktuar prioritetet dhe krijuar mekanizma të cilët e matin efikasitetin e kompanive (profitin e firmës), ndërsa përparësitë e modelit “stakeholder” janë përparësitë që i japin kompanisë për tejkalimin e problemeve.

Njëra nga sfidat më të mëdha për reforma është identifikimi i kornizave të punës dhe mekanizmave të cilët krijojnë nivele eficientë të investimit dhe në të njëjtën kohë e mbajnë aspektet e përgjegjësisë performuese të siguruara nga modeli i “aksionareve”. Objektivat “stakeholder” nuk duhet të përdoren për parandalimin e udhëzimeve se si caktohen objektivat dhe prioritetet e firmës para se të njëjtat të sqarohen.

## 4. EFEKTET E QEVERISJES SË KORPORATAVE NË PERFORMANCËN E FIRMËS

Ne këtë kapitull do të tregojmë se si ndikon qeverisja në performancën financiare të korporatës, të cilën e definojmë si mundësi të rritjes së profitit në nivel të caktuar. Sipas bankës botërore<sup>9</sup>, qeverisja e korporatave përfshin dy mekanizma, qeverisjen e jashtme dhe të brendshme të korporatës. Qeverisja e brendshme e korporatave i jep prioritet të interesave aksionareve, vepron në bordin e drejtoreve për monitorimin e menaxhmentit të lartë ndërsa qeverisja e jashtme e korporatave monitoron dhe kontrollon sjelljen e menaxhereve.

Qeverisja e mirë e korporatave i rritë vlerat dhe studimi i Gompërs, Ishii dhe Metrick (2003)<sup>10</sup> ka treguar që kompanitë të cilat aksionaret kanë me shume të drejta kanë krijuar kthime vjetore 8.5 për qind me shume se kompanitë në cilat aksionaret kanë pasur me shume të drejta; ndikon në uljen e kostove të auditimit dhe monitorimin e aksionareve, gjë që qon në vlerësim me të lartë të kompanisë. Kompanitë me vlere me të lartë të tregut kanë strukture me të mirë të qeverisjes dhe përdorin praktika me të mira qeverisëse për t'i ulur shpenzimet e kapitalit. Nëse qeverisja nuk është e mirë atëherë firmat mund të ballafaqohen me probleme serioze. Pasojat me të mëdha të një qeverisje të dobët të korporatave janë shpërndarja e burimeve njerëzore që rezulton në paaftësi të kompanive për t'i tërheqje të investimeve. Nëse një kompani ka pronare të shumëfishtë atëherë mund të ballafaqohet me probleme të qeverisjes së korporatave. Kompanitë të cilat iu kanë dhënë aksionareve me shume të drejta kanë pasur me shume vlere, janë vlerësuar me shume, kanë pasur rritje të shitjeve dhe shpenzime me të ulëta të kapitalit.

Ekzistojnë tri lloje të qeverisjes që aplikohen nga organizata të ndryshme:

- Gjysmë demokratike
- Demokratike
- Diktatoriale.

Kompanitë në të cilat aksionaret kanë pasur me shume të drejta kanë qene pjese e 'portfolios demokratike' ndërsa kompanitë në të cilat aksionaret kanë me pak të drejta ishin pjese e një 'portofolio diktatoriale'.

---

<sup>9</sup> World Bank; [www.world-bank.org](http://www.world-bank.org)

<sup>10</sup> Gompërs, Ishii and Metrick (2003)

Gjithmonë ekziston një shkëmbim ndërmjet interesave të drejtoreve dhe interesave të aksionareve. Edhe pse drejtoret janë ata të cilët i caktojnë udhëheqësit e korporatave, problemet paraqitën gjatë distribuimi të profitit dhe mbajtjes së fondeve brenda kapitalit të kompanisë. Sipas Kenneth Tombs 2002<sup>11</sup>, ekzistojnë kategori të ndryshme të punëtorëve të cilët i kishte ndare në tri stile të qeverisjes. Se pari, punëtorët të cilët besojnë që roli i punëtorëve qeverisës është konstruktiv dhe me përgjegjësi; se dyti, punëtorët besojnë që rregullat qeverisëse krijojnë panik në mes të punëtorëve dhe se treti, punëtorët të cilët besojnë që personat qeverisës janë jo kompetent ndaj punës së tyre dhe krijojnë stil autokratik.

#### **4.1. QEVERISJA E KORPORATAVE DHE MBROJTJA E INVESTITORËVE**

Financimi i firmave nga investitorët ndikon që ata të kenë ndikim të caktuar dhe të mbrohen nga zbatimi i rregullave të cilat burojnë nga kompania, siguria, bankroti, rregullat e stoqeve dhe standardet e kontabilitetit. Disa prej rregullave iu japin informacionet që janë të nevojshme për ushtrimin e të drejtave si në vijim: pranimi i dividendave në mënyrë proporcionale, votimi i drejtorëve, pjesëmarrja në mbledhje të aksionarëve, padija ndaj drejtorëve në rast dyshimi për shpronësim e të tjera. Investitorët mbrohen edhe me ligj që pjesërisht zbatohet nga rregullat e tregut, gjyqi dhe nga pjesëmarrësit në treg. Ekzistojnë edhe ligje për mbrojtjen e kreditorëve që zakonisht kanë të bëjnë me bankrot dhe procedura të riorganizimit, gjë që e bën më të vështirë për firmat të kërkojnë mbrojtje gjyqësore gjatë këtij procesi. Të gjitha të drejtat e investitorëve, aksionarëve ose kreditorëve duhet të mbrohen me ligj sepse mbrojtja e pjesshme e këtyre të drejtave do të ndikoj që pronarët të mos i paguajnë kreditorët dhe të distribuojnë profitin tek aksionarët. Ligji penalizon të gjitha ato firma të cilat nuk i zbulojnë informacionet që kanë të bëjnë me riskun e shpronësimit dhe në të njëjtën kohë i detyron pronarët të kenë marrëdhënie kontraktuale me investitorët dhe t'i trajtojnë në mënyrë të duhur. Zbatimi i kontratave privatë përmes sistemeve gjyqësore ka shpenzime të mëdha prandaj ekzistojnë edhe forma të tjera për mbrojtjen e të drejtave pronësore (zbatimi i rregullave nga qeveria) që janë më efikase, për këtë arsye është më mirë

---

<sup>11</sup> Kenneth Tombs (2002), "What do we mean by governance?", Records Management Journal, Vol. 12 Iss: 1, pp.24-28



qe të ekzistojnë kontrata ligjrisht të limituara. Shtetet e zhvilluara kanë krijuar ligje specifike për mbrojtje të investitorëve, gjë qe ka zhvilluar më shumë tregun kapital.

Kosova ende nuk ka krijuar një sistem gjyqësor të mirëfilltë qe ofron siguri të mjaftueshme për investitorët. Disa ligje duhet të ndryshohen e disa të tjera të krijohen.

## 5. QEVERISJA E NDËRMARRJEVE PUBLIKE NË KOSOVË

Qeveria e Kosovës është pronare e ndërmarrjeve publike dhe si e tillë obligohet që ta ushtroje të drejtën e saj pronësore. Qeveria ka nxjerrë disa ligje në lidhje me ndërmarrjet publike (ligji për shoqërinë tregtare, ligji për ndërmarrjet publike) por këto të fundit nuk po zbatohen në mënyrë të duhur. Si rezultat i kësaj ndërmarrjet publike nuk ofrojnë shërbime cilësore për qytetarët. Një shembull tipik është Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) që ofron shërbime jo cilësore për qytetarët duke u nisur nga fakti që qeveria ka vendosur të privatizojë një pjesë të saj. Dy elementë të tjera të cilat kanë ndikuar në performancën e dobët të kompanisë janë mungesa e ristrukturimit të kësaj kompanie dhe punësimi i njerëzve të pa kualifikuar (Rinvest, 2009).

Sektori i distribuimit të energjisë elektrike si pjesë e KEK-ut është privatizuar në vitin 2012 nga kompania turke Limak&Calik për 26.3 milion euro pavarësisht nga kritikën e shumta në lidhje me transparencën e këtij procesi.

Qeveria e Kosovës është përpjekur që të privatizojë edhe ndërmarrjen tjetër publike, Posta dhe Telekomit të Kosovës (PTK), gjë që ka rezultuar në krijimin e Telekomit dhe Postës së Kosovës. Telekomit të Kosovës (që përfshinë telefoninë fikse dhe mobile) do të privatizohet ndërsa Posta e Kosovës do të mbetet edhe me tutje ndërmarrje publike. Në vitin 2011 privatizimi i Telekomit të Kosovës ka dështuar si rezultat i aferave korruptive por ky proces do të shqyrtohet në të ardhmen e afërt.

Dy elementë kryesorë të cilat e kanë ulur vlerën e këtyre ndërmarrjeve gjatë procesit të privatizimit janë transparenca dhe keq-menaxhimi, prandaj edhe interesimi i investitorëve të huaj për privatizimin e këtyre të fundit ka qenë i ulët.

Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka parapare që të krijojë Njësinë për Politikë dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPMNP) të përbërë nga 12 persona me qëllim të ushtrimit të përgjegjësisë së qeverisë së Kosovës si aksionare e ndërmarrjeve publike (NP). Deri tash kjo njësi ka vetëm gjashtë persona dhe udhëheqësin e saj për arsye të kufizimeve buxhetore, pra ende nuk është punësuar analisti për auditim dhe monitorim të NP-ve. Kjo njësi së bashku me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm mbledhin dokumentacionin dhe japin propozime për mbikëqyrjen e ndërmarrjeve publike. Deri në kompletimin e kësaj njësie, qeveria nuk do të ketë njohuri të nevojshme për krijimin e masave që do të përmirësojnë qeverisjen e korporatave.

NJPMNP duke marre parasysh parimet e OECD-se për qeverisje të korporatave dhe me mbështetjen teknike të USAID ka hartuar Kodin e Etikes dhe Qeverisjes së Korporatave ne baze të Nenit 35 të ligjit mbi Ndërmarrjet Publike për ta mbikëqyrë veprimtarinë e NP, avancimin e qeverisjes se korporatave dhe zvogëlimin e parregullsive ne qeverisje. Kodi i Etikes përbehet prej 72 faqe dhe ne të janë të shkruara parimet dhe praktikat qe duhet zbatuar gjatë qeverisjes se korporatave. Ky dokument gjithashtu jep edhe udhëzime se si duhet të sillen dhe veprojnë drejtoret, këshilltarët dhe punonjësit e ndërmarrjeve ne mënyrë qe të sigurohet një qeverisje e mirëfilltë dhe të evitohen problemet e mundshme. Ky dokument përveç tjerash trajton edhe këto aspekte: përdorimin e asetëve të ndërmarrjes, korrupsionin, politikat dhe menaxhimin e ndërmarrjes, politikat pronësore të qeverise, takimet e bordit, vlerësimet e performancës etj.

NJPMNP me ane të ligjit për NP është e obliguar të monitoroje dhe vlerësojë performancën e NP dhe të merr pjese ne mbledhjet e bordit vetëm si vëzhguese. NJPMNP gjithashtu duhet t'i ndihmoje bordit të NP (me ane të udhëzuesve) qe ta bëjnë raportin ne lidhje me përparimet dhe ngecjet gjatë qeverisjes. Ne baze të ligjit, NJPMNP i vlerëson NP edhe me mënyrë individuale përmes analizës se punës se bordit, punës e komiteteve pranë bordit, raporteve të auditorëve dhe dokumenteve të tjera. NJPMNP ka bere një raport vlerësues ne vitin 2010 për dy ndërmarrjet publike (KEK dhe PTK) dhe ka ardhur ne përfundim qe KEK-u i ka përmbushë me sukses disa detyra të parashtruara siç është përmbushja e planit të biznesit dhe respektimi i Kodit të Etikes dhe Qeverisjes së Korporatave. KEK-u gjithashtu ka arritur rezultate pozitive ne auditim të brendshëm të ndërmarrjes me qellim të ngritjes se përgjegjshmërisë. PTK-ja ne anën tjetër nuk ka arritur t'i përmbushë ne tërësi detyrat e parapara. Kjo ndërmarrje ka ngecur ne përmbushjen e planit të biznesit qe parasheh rritjen e performancës financiare të ndërmarrjes. Bordi i PTK-se nuk ka arritur t'i aprovoje aktet nënligjore dhe aktet e Kodit të Etikes dhe Qeverisjes së Korporatave, prandaj edhe janë shfaqur këto mangësi ne përmbushjen e detyrave të parapara.

NJPMNP ne baze të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe Ligjit për Ndërmarrjet Publike ka përgatitur një doracak i cili do t'ju ndihmoje anëtarëve të bordit lidhur me rolin dhe përgjegjësitë e tyre sepse është vërejtur një mangësi ne përvojën e tyre. Ky doracak i qartëson edhe detyrat e drejtoreve të ndërmarrjeve si dhe përfshinë çështjen e konfliktit të interesit. NJPMNP ne bashkëpunim me USAID dhe IFC qe nga viti 2009 ka filluar të organizoj trajnime për sekretaret e NP dhe anëtarët e bordeve. Sekretaret e NP të cilët janë ne

komunikim të drejtpërdrejtë me aksionaret dhe anëtarët e bordit, përgatisin raportet nga takimet e bordit dhe në këtë mënyrë rritët kontrolli i brendshëm i ndërmarrjes. Anëtarët e bordeve kryesisht trajtohen për një menaxhim me të mirë të ndërmarrjeve publike dhe riskut.

NP në baze të Nenit 29 të Ligjit për NP janë të obliguara që të bëjnë raporte lidhur me nivelin e kënaqshmërisë së konsumatorëve për shërbimet që i ofrojnë këto ndërmarrje, por një studim i UNDP-se tregon që konsumatorët nuk janë të kënaqur me shërbimet të cilat ju ofrohen.

## 6. KONKLUDIMI

Qeverisja e korporatave merret me problemin e agjencisë: ndarja e menaxhmentit dhe financave. Qëllimi i qeverisjes se korporatave është që t'ju sigurojë financuesve kthimin e investimeve të tyre sepse shumica e investitorëve mund t'i ri-distribujnë investimet e të tjerëve në mënyrë joefikase për vetvete.

Sisteme të suksesshme të qeverisjes se korporatave siç janë ato të SHBA, Gjermanisë dhe Japonisë përfshijnë mbrojtjen ligjore dhe rolin e rëndësishëm të investitorëve kryesor. Ky lloj sistemi i qeverisjes se korporatave i dallon nga sistemet e qeverisjes se korporatave të shteteve të tjera të cilat sigurojnë mbrojtje ligjore të limituar të investitorëve dhe nga firmat e brendshme duke përfituar shume pak financim nga jashtë.

Gjatë hulumtimit kemi hasur në shume pyetje të cilat kanë mbetur pa përgjigje. Ende nuk ekzistojnë përgjigje të sakta, edhe pse në shume raste janë paraqitur opinione të ndryshme për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve.

Sisteme të qeverisjes se korporatave ndër shtete ndryshojnë varësisht nga lloji i mbrojtjes ligjore të investitorëve. Ligjet mbi korporatat dhe zbatueshmëria e këtyre ligjeve janë të ndryshme në vende të ndryshme. Rregullat ligjore janë një faktor mjaft i rëndësishëm në qeverisjen e korporatave sepse rezistenca ndaj investitorëve të mëdhenj ka ndikuar në evoluimin e qeverisjes se korporatave. SHBA-të zbatojnë një rregull të tillë mbi qeverisjen e korporatave prandaj dominojnë në këtë fushë në krahasim me shtetet tjera.

Nga kjo që u tha më lartë, konkludoj se shtetet duhet vazhdimisht të përmirësojnë qeverisjen e korporatave sepse kjo inkurajon investitorët global që të investojnë në fusha të ndryshme; zvogëlojnë kostot e kapitalit për arsye se investitorët kanë njohuri më të mira për strategjinë dhe performancën e kompanisë; përmirësojnë performancën e kompanisë; rrisin vlerësimin e firmës dhe performancën e aksioneve dhe zvogëlojnë riskun që korporatat të futen në krize.

## 7. METODOLOGJIA

Metodologjia përdoret për zgjedhjen e problemeve me ane të metodave shkencore. Disa nga metodat themelore të kërkimit janë:

- Deskriptive
- Kualitative
- Kuantitative
- Hulumtuese etj.

Metoda deskriptive me ane të mbledhjes së informacioneve paraqet gjendjen ekzistuese të një situatë. Sipas Gay 1976, kjo metode përfshinë mbledhjen e informacioneve në mënyrë që të testohen hipotezat ose t'i përgjigjemi pyetjeve që kanë të bëjnë me situatën aktuale të objektit të studimit<sup>12</sup>.

Metoda kualitative dhe kuantitative janë teknika të cilat përdoren për të shpjeguar situatën aktuale të objektit të studimit. Teknika kuantitative matë kuantitetin ose sasinë e një fenomeni ndërsa teknika kualitative fokusohet në kualitetin e fenomenit.

Metoda hulumtuese përdoret për të shpjeguar problemet të cilat janë definuar qartë. Kjo metode zakonisht bazohet në kërkime sekondare siç janë shqyrtimi i literaturës ose diskutimet jo-formale me punëtorët në korporata. Kjo metode nuk na jep informacione të mjaftueshme për vendimmarrje por vetëm një pasqyre të gjendjes aktuale.

Në këtë punim është përdorur metoda deskriptive për mbledhjen e informacioneve dhe paraqitjen e situatave të ndryshme gjatë qeverisjes së korporatave.

---

<sup>12</sup> What is the Descriptive Method of Research, Gay 1976

## 8. LITERATURA

1. Stijn Claessens and Burcin Yurtoglu, 2012.  
*10 FOCUS, Corporate Governance and Development*  
[[http://www.gcgf.org/wps/wcm/connect/518e9e804a70d9ed942ad6e6e3180238/Focus10\\_CG%26Development.pdf?MOD=AJPERES](http://www.gcgf.org/wps/wcm/connect/518e9e804a70d9ed942ad6e6e3180238/Focus10_CG%26Development.pdf?MOD=AJPERES)]
2. Kesho Prasad, 2009.  
*Corporate Governance*  
[<http://books.google.com/books?id=C32RMKyXmKcC&pg=PT8&lpg=PT8&dq=preface+on+corporatë+governance&source=bl&ots=SdBveOprij&sig=3obgdOftia-0h9AKjVgJ92GqOEo&hl=en&sa=X&ei=CekIUfrrF8matQbl2YCeAQ&ved=0CHIQ6AEeCDgy>]
3. Maria Maher and Thomas Andersson, 1999.  
*Corporate Governance: Effects on Firm performance and Economic Growth*
4. Agrawal, A., & Knoeber, C. 1996.  
*“Firm Performance and Mechanisms to Control Agency Problems between Managers and Shareholders.” Journal of Financial & Quantitative Analysis, 31, 377-397*
5. Black, B., H. Jang, and W. Kim, 2003  
*Does Corporate Governance Affect Firm Value?, Working paper 327, Stanford Law School*
6. Mobeen Ur Rehman and Aabid Hussain, 2013  
*Impact of Corporate Governance on Firm Performance*  
[<http://journal-archieives30.webs.com/581-601.pdf>]
7. Insituti Riinvest  
[www.riinvestinstitute.org](http://www.riinvestinstitute.org)